REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

KRYETARI

25103

Nr._____ Prot

Shkodër, më 09.10.2026

Lënda: Dërgohet për shqyrtim projekt-vendim dhe relacioni "**Për një ndryshim në VKB nr.84, datë 18.12.2025 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2026-2028 të Bashkisë Shkodër", i ndryshuar.**

KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR

Të nderuar këshilltarë,

Bashkëngjitur ju dërgojmë për shqyrtim projekt-vendimin dhe relacionin: "**Për një ndryshim në VKB nr.84, datë 18.12.2025 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2026-2028 të Bashkisë Shkodër", i ndryshuar;**

Duke ju uruar punë të mbarë.

Me respekt,

KRYETAR

Benet BECI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA SHKODËR

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

KRYETARI

Nr._____ Prot Shkodër, më ____.____.2026

PROJEKT-VENDIM

Nr._____, datë____.____.2026

Për një ndryshim në VKB nr. 84, datë 18.12.2025 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2026-2028 të Bashkisë Shkodër", i ndryshuar.

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës_____._____.2026, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 54 shkronja "dh" të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar; ligjit nr.68/2017 "Për financat vendore", i ndryshuar; ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; ligjit nr.10296, datë 8.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"; i ndryshuar, ligjit 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; Udhëzimit nr. 9, datë 20.3.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë "Për proçedurat standarde të zbatimit të buxhetit", të ndryshuar; ligjit nr. 69/2012, "Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, VKB nr.84, datë 18.12.2025 "Për miratimin e buxhetit te vitit 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2026-2028 të Bashkisë Shkodër", i ndryshuar, si dhe relacionit të përgatitur nga administrata e Bashkisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimin në VKB nr.84, datë 18.12.2025 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2026-2028 të Bashkisë Shkodër",i ndryshuar, pika 1 germa g), sa i takon numrit total të punonjësve të Bashkisë Shkodër, sipas tabelës së SMBV, pjesë përbërese e këtij vendimi.

2. Fondi i pagave për punonjesit shtesë të Bashkisë Shkodër përballohet nga fondet e trashëguara nga viti 2025 pjesë e buxhetit të bashkisë të vitit 2026.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R
Benet BECI

ZV/KRYETAR

Drejtoria e Përgjithshme Juridike, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse

Drejtoria Juridike

Drejtoria e Burimeve Njerezore dhe Sherbimeve mbështetese

Drejtoria e Administrimit të Sistemeve, Menaxhimit të ZIN, Projekteve TIK dhe Menaxhimit të Sistemeve të Informacionit

Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Trajtimit të AMTP-ve

Drejtoria e Arsimit

Drejtoria e Policisë Bashkiake

Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike, institucion varësie

Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar

Drejtoria e Analizës dhe Programimit Buxhetor

P/ *Drejtoria e Financës*

Ishte
Raporti : BV5 - Numri i Punonjesve te NJQV
NJQV : 141- Bashkia Shkoder
Buxheti : 2026

Institucioni	Kodi i institucionit	Numri i punonjesve të miratuar	Numri i punonjësve me kontratë
Bashkia Shkodër	2141001	659	28
Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpetimit	2141042	55	
Ndërmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike	2141044	146	10
Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike	2141045	248	
NUMRI I PUNONJËSVE		**1,108**	**38**
TOTALI (Efektet financiare me fondet e veta)		**1,146**	
Gjendja Civile - Efektet financiare me transfertë të kushtëzuar)	2141001	7	
TOTALI- (Efektet financiare me transfertë të kushtëzuar)		7	

Bëhet
Raporti : BV5 - Numri i Punonjesve te NJQV
NJQV : 141- Bashkia Shkoder
Buxheti : 2026

Institucioni	Kodi i institucionit	Numri i punonjesve të miratuar	Numri i punonjësve me kontratë
Bashkia Shkodër	2141001	693	28
Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpetimit	2141042	55	
Ndërmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike	2141044	146	10
Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike	2141045	251	
NUMRI I PUNONJËSVE		**1,145**	**38**
TOTALI (Efektet financiare me fondet e veta)		**1,183**	
Gjendja Civile - Efektet financiare me transfertë të kushtëzuar)	2141001	7	
TOTALI- (Efektet financiare me transfertë të kushtëzuar)		7	

K R Y E T A R
Benet BECI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR
KRYETARI

RELACION

Për një ndryshim në VKB nr. 84, datë 18.12.2025 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2026-2028 të Bashkisë Shkodër", i ndryshuar;

Të nderuar këshilltarë,

Në mbështetje të nenit 54 shkronja "dh", ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar; ligjit nr.68/2017 "Për financat vendore", i ndryshuar; ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; ligjit nr.10296, datë 8.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"; ligjit 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; Udhëzimit nr.9, datë 20.3.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë "Për proçedurat standarde të zbatimit të buxhetit", të ndryshuar; ligjit nr. 69/2012, "Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, VKB nr.84, datë 18.12.2025 "Për miratimin e buxhetit te vitit 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2026-2028 të Bashkisë Shkodër",i ndryshuar, Bashkia Shkodër paraqet për shqyrtim relacionin për:

1. Miratimin e rritjes së numrit të punonjësve në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, nga 23 që është aktualisht në 27 punonjës.
2. Miratimin e rritjes së numrit të punonjësve në Drejtorinë e Administrimit të Sistemeve, Menaxhimit të ZIN, Projekteve TIK dhe Menaxhimit të Sistemeve të Informacionit, nga 13 që është aktualisht në 22 punonjës.
3. Miratimin e rritjes së numrit të punonjësve në Drejtorinë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Trajtimit të AMTP-ve, nga 6 që është aktualisht, në 7 punonjës.
4. Miratimin e rritjes së numrit të punonjësve në Drejtorinë e Arsimit, nga 244 që është aktualisht, në 254 punonjës.
5. Miratimin e rritjes së numrit të punonjësve në Drejtorinë e Policisë Bashkiake, nga 58 që është aktualisht në 68 punonjës.
6. Miratimin e rritjes së numrit të punonjësve në Drejtorinë e Përgjithshme të Mirëmbajtjes së Objekteve Publike, institucion në varësi të Bashkisë Shkodër, nga 248 që është aktualisht, në 251 punonjës.

Pra në total një rritje prej 37 punonjësish.

- ***Kërkesa për rritjen e numrit të punonjësve tek Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse*** *vjen për arsye si vijon:*

Në kuadër të garantimit të kushteve të përshtatshme të higjienës, pastërtisë dhe mirëmbajtjes së ambienteve të administratës, vlerësohet e nevojshme shtimi i **4 (katër) pozicioneve të punës për sanitare** në strukturë.

Kjo nevojë lidhet me sipërfaqen dhe numrin e ambienteve që duhet të mirëmbahen, numrin e punonjësve dhe të personave që frekuentojnë institucionin, si dhe me kërkesën për garantimin e standardeve të higjienës dhe pastërtisë gjatë gjithë orarit të punës.

Shtimi i 4 pozicioneve për sanitare do të mundësojë:

- garantimin e pastrimit dhe dezinfektimit të rregullt të ambienteve;
- mbulimin e të gjitha hapësirave të institucionit;
- përmirësimin e kushteve të higjienës dhe sigurisë në vendin e punës;
- shpërndarjen më të mirë të ngarkesës së punës;
- rritjen e cilësisë së shërbimit dhe mirëmbajtjes së ambienteve administrative.

Për sa më sipër, **propozohet miratimi i shtimit të 4 (katër) pozicioneve të punës për sanitare** në strukturën dhe organikën e institucionit, në përputhje me nevojat reale të institucionit.

- ***Kërkesa për rritjen e numrit të punonjësve tek Drejtoria e Administrimit të Sistemeve, Menaxhimit të ZiIN, Projekteve TIK dhe Menaxhimit të Sistemeve të Informacionit*** *vjen për arsye si vijon:*

Bashkia Shkodër ushtron funksionet dhe ofron shërbimet e saj në një territor të gjerë, të përbërë nga 11 njësi administrative dhe 92 fshatra. Kjo shtrirje, së bashku me shtimin e procedurave elektronike, krijon një kërkesë të vazhdueshme për informim dhe asistencë të drejtpërdrejtë ndaj qytetarëve.

Zyra me Një Ndalesë, pranë Drejtorisë së Administrimit të Sistemeve, Menaxhimit të Z1N, Projekteve TIK dhe Menaxhimit të Sistemeve të Informacionit, është pika kryesore e kontaktit të qytetarëve me Bashkinë. Ajo informon dhe orienton qytetarët, regjistron dhe ndjek aplikimet, kërkesat dhe ankesat, si dhe ofron asistencë për procedurat bashkiake dhe përdorimin e platformës e-Albania.

Sipas strukturës aktuale, Zyra me Një Ndalesë ka 8 specialistë. Ndërkohë, në vitin 2025 janë realizuar rreth 30.000 kërkesa për shërbime administrative elektronike dhe 69 shërbime elektronike, numër që pritet të rritet çdo vit me shtimin e shërbimeve digjitale. Për të përballuar fluksin e kërkesave, për të garantuar funksionimin e vazhdueshëm të

sporteleve dhe për të ndihmuar qytetarët që kanë vështirësi në përdorimin e shërbimeve digjitale, propozohet shtimi i **8 (tetë) pozicioneve të reja në nivel specialisti** në Zyrën me Një Ndalesë.

Gjithashtu, propozohet shtimi i **1 (një) pozicioni për informimin dhe orientimin e qytetarëve**. Ky punonjës do të presë qytetarët, do të dëgjojë problematikën e tyre dhe do t'i orientojë drejt sportelit, drejtorisë ose strukturës përgjegjëse. Kjo do të shmangë pritjet dhe lëvizjet e panevojshme të qytetarëve brenda institucionit.

Punonjësit e rinj do të angazhohen në informimin dhe orientimin e qytetarëve, asistencën për e-Albania, regjistrimin dhe ndjekjen e kërkesave, si dhe koordinimin me strukturat e Bashkisë dhe njësitë administrative.

Shtimi i personelit pritet të sjellë uljen e kohës së pritjes dhe trajtimit të kërkesave, përmirësimin e cilësisë së shërbimit, shpërndarjen më të mirë të ngarkesës dhe rritjen e aksesit të qytetarëve në shërbimet bashkiake dhe elektronike.

Për sa më sipër, propozohet miratimi i shtesës prej **9 (nëntë)** pozicioneve të reja të punës

- ***Kërkesa për rritjen e numrit të punonjësve tek Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Trajtimit të AMTP-ve*** *vjen për arsye si vijon:*

Në kuadër të funksionimit dhe mirëmbajtjes së strehëzës së qenve, si dhe për garantimin e kushteve të përshtatshme për trajtimin dhe përkujdesjen ndaj kafshëve të strehuara duke marrë në konsideratë numrin e qenve të strehuar dhe nevojën për përkujdesje të vazhdueshme, kërkohet;

Shtesë 1 (një) punonjësi shërbimi pranë Drejtorisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Trajtimit AMTP.

Punonjësi do të angazhohet me kujdesin e përditshëm ndaj qenve të strehuar, ushqyerjen dhe furnizimin me ujë, pastrimin dhe higjienizimin e kolibeve dhe ambienteve të qëndrimit, mirëmbajtjen e hapësirave të strehëzës, si dhe asistimin gjatë trajtimit, zhvendosjes apo sistemimit të qenve, sipas nevojës.

- ***Kërkesa për rritjen e numrit të punonjësve tek Drejtoria e Arsimit*** *vjen për arsye si vijon:*

Në analizën e bërë për vitin shkollor 2026–2027 duke u bazuar në:

- Numrin aktual të nxënësve

- Kërkesat e Ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar" për mbërritjen/dhënien e mbështetjes për nxënësit.
- Standardet minimale të higjienës, ushqimit dhe mbikëqyrjes së përkaktuar nga udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës;

Nisur nga numrin aktual të personelit të miratuar me VKB nr. 84 date 18.12.2025, i ndryshuar për arsimin, është konstatuar se struktura ekzistuese e stafit nuk është e mjaftueshme për të garantuar:

1. Mbikëqyrjen e vazhdueshme dhe të plotë të nxënësve;
2. Sigurinë fizike dhe emocionale të nxënësve;
3. Zbatimin e detyrimeve ligjore për mirëqënien dhe përfshirjen e plotë të nxënësve

Për rrjedhojë është e domosdoshme;

1- **Të shtohet 1 (një) pozicion punonjës mbështetës, kujdestar në strukturën e shkollës speciale "3 Dhjetori".**

Shtimi i këtij pozicioni është i nevojshëm në kuader të përmirësimit të performancës dhe kritereve e standarteve të ofrimit të shërbimit.

Shkolla speciale "3 Dhjetori" është një institucion i arsimit parauniversitar që ofron shërbime arsimore dhe kujdesi të përshtatura për fëmijë me aftësi të kufizuara të rënda dhe shumë të rënda, përfshirë çrregullime neuro-zhvillimore (si autizmi), aftësi të kufizuara të rënda intelektuale, motorike dhe shqisore.

Shumë nga nxënësit e kësaj shkolle kërkojnë mbikëqyrje të vazhdueshme, asistencë në aktivitetet e jetës së përditshme (higjienë, ushqim, lëvizje) dhe mbështetje emocionale intensive gjatë gjithë ditës shkollore. Në analizën e bërë për vitin shkollor 2026-2027, duke u mbështetur në numrin e nxënësve me nevoja të veçanta të renda si dhe kërkesat e Ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar", është konstatuar për shkak të strukturës aktuale të stafit nuk sigurohet mbulim i mjaftueshëm për nevojat e nxënësve me aftësi të kufizuara të renda.

Ky kujdestar do të:

- asistojë nxënësit me aftësi të kufizuara gjatë gjithë ditës shkollore;
- bashkëpunojë ngushtë me mësuesit e klasës;
- sigurojë shoqërimin e fëmijëve gjatë transportit dhe ndihmën mbështetëse për higjienën personale të fëmijëve.

Për të siguruar një menaxhim efektiv të këtyre proceseve dhe për të shmangur mbingarkesën mbi strukturat aktuale, propozohet shtimi i numrit të punonjësve, që do të angazhohen me detyra të qarta sipas urdhërave të punës dhe nevojave operative në sektor

2- **Të shtohet 1 (një) pozicion punonjës mbështetës, kujdestar në strukturën e konvikteve.**

Rritja e kërkesës për regjistrimin dhe akomodimin e nxënësve pranë Konviktit "Prenk Jakova" ka sjellë një shtim të numrit të nxënësve rezidentë dhe, për rrjedhojë, një rritje të nevojave për mbikëqyrje dhe kujdes gjatë qëndrimit të tyre në institucion.

Në këtë kuadër, si dhe në vijim të kërkesës për miratimin e regjistrit të nxënësve të akomoduar në konvikt për vitin shkollor 2026–2027, kërkohet shtimi i një pozicioni punonjës mbështetës "Kujdestar" në strukturën e personelit të konviktit.

3- **Të shtohet 8 (tetë) pozicione edukator mbështetës, në strukturën e kopshteve dhe çerdheve.**

Në kuadër të rritjes së vazhdueshme të kërkesave për regjistrimin e nxënësve me aftësi ndryshe nga ku për vitin akademik 2026-2027 janë rreth 40 fëmijë me aftësi ndryshe të regjistruar si dhe me qëllim garantimin e një arsimimi gjithëpërfshirës dhe mbështetjes së nevojshme për çdo nxënës, është e nevojshme **shtimi i numrit të mësuesve mbështetës** në institucionin tonë.

Gjatë periudhës së fundit është konstatuar një **rritje e kërkesave për regjistrimin e fëmijëve me aftësi ndryshe**, duke sjellë nevojën për rritjen e kapaciteteve të stafit mbështetës. Numri aktual i mësuesve mbështetës nuk është i mjaftueshëm për të përmbushur nevojat e të gjithë nxënësve që kërkojnë mbështetje të specializuar. Kjo masë do të kontribuonte drejtpërdrejt në garantimin e një shërbimi arsimor cilësor, gjithëpërfshirës dhe të barabartë për të gjithë nxënësit.

Ky edukator mbështetës do të mundësojë:

- Të ofrojë mbështetje individuale për nxënësin me aftësi ndryshe gjatë procesit mësimor dhe veprimtarive të tjera shkollore.

- Të ndihmojë nxënësin në kuptimin dhe realizimin e detyrave mësimore, duke i përshtatur ato sipas nivelit dhe nevojave të tij.
- Të ndihmojë në zhvillimin e aftësive të komunikimit, socializimit, ndërveprimit dhe autonomisë së nxënësit.
- Të zbatojë dhe të ndjekë objektivat e përcaktuara në planin edukativ individual të nxënësit.

• Të monitorojë dhe dokumentojë ecurinë, përparimin dhe vështirësitë e nxënësit, duke informuar mësuesin e klasës dhe strukturat përkatëse..
• Të ndihmojë në krijimin e një mjedisi të sigurt, gjithëpërfshirës dhe mbështetës, të përshtatur me nevojat individuale të nxënësit.

• Të kontribuojë në rritjen e pavarësisë së nxënësit, duke synuar që mbështetja të përshtatet me përparimin dhe aftësitë e tij.

- ***Kërkesa për rritjen e numrit të punonjësve tek Drejtoria e Policia Bashkiake*** *vjen për arsye si vijon:*

Policia Bashkiake është strukture e cila ushtron detyrat dhe kompetencat e saj në mbështetje të kuadrit ligjor në fuqi, konkretisht të ligjit nr. 89/2022 "Për Policinë Bashkiake", ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, vendimeve të Këshillit Bashkiak, si dhe akteve të Kryetarit të Bashkisë.
Si strukturë ekzekutive në nivel vendor, Policia Bashkiake ka për detyrë të kontribuojë në garantimin e sigurisë, qetësisë dhe rendit publik, administrimin dhe mbrojtjen e hapësirave publike, si dhe zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore në fushën e përgjegjësive të saj.
Duke marrë në konsideratë rolin dhe rëndësinë e kësaj strukture, shtrirjen e gjerë territoriale në ushtrimin e kompetencave të saj, konkretisht në të gjithë territorin administrativ të Bashkisë Shkodër,duke përfshirë qytetin, lagjet dhe njësitë administrative, si dhe mbështetjen që i ofron strukturave të tjera të Bashkisë rezulton se Policia Bashkiake përballet me një gamë të gjerë detyrash dhe përgjegjësish.
Në kuadër të funksioneve të saj, përveç ushtrimit të kompetencave në territor, Policia Bashkiake angazhohet edhe në ruajtjen dhe mbikëqyrjen e godinave në pronësi apo administrim të Bashkisë, menaxhimin dhe monitorimin e sistemit të kamerave të sigurisë nëpërmjet Sallës së Kontrollit si dhë menaxhimin e pikës së grumbullimit të mjeteve. Shtimi i këtyre funksioneve dhe zgjerimi i shërbimeve, së bashku me nevojën për garantimin e mbulimit të shërbimit edhe në turnin e tretë, kanë rritur ndjeshëm ngarkesën dhe përgjegjësitë e kësaj strukture.
Një aspekt i rëndësishëm i veprimtarisë së Policisë Bashkiake lidhet edhe me menaxhimin dhe reagimin në situata të emergjencave civile.
Pika 2, germa "a", e nenit 9 të ligjit nr. 89/2022 "Për Policinë Bashkiake", përcakton se Policia Bashkiake merr masa të sigurisë për zbatimin e planit të emergjencës së bashkisë për parandalimin e fatkeqësive të ndryshme natyrore, si dhe bashkëpunon me strukturat e mbrojtjes civile pranë bashkisë dhe prefektit të qarkut për kapërcimin e tyre.
Në kushtet e territorit të gjerë administrativ të Bashkisë Shkodër dhe të problematikave të shumta në numër që lidhen me emergjencat civile, si përmbytjet, zjarret dhe fatkeqësi të tjera natyrore, përmbushja e kësaj kompetence kërkon kapacitete të posaçme njerëzore dhe organizative.

Struktura aktuale dhe numri i kufizuar i punonjësve e bëjnë të vështirë reagimin në kohë dhe në mënyrë të koordinuar ndaj situatave emergjente, veçanërisht kur këto situata shfaqen njëkohësisht në zona të ndryshme të territorit të Bashkisë Shkodër.
Për sa më sipër, lind nevoja për shtimin e numrit të punonjësve të Policisë Bashkiake Shkodër e cila si funksion kryesor ndër të tjera do të ketë reagimin e menjëhershëm, mbështetjen dhe bashkëpunimin me strukturat përgjegjëse të mbrojtjes civile në rastet e përmbytjeve, zjarreve dhe situatave të tjera emergjente e cila do të mundësonte një reagim më të shpejtë dhe më efektiv në terren, do të rriste kapacitetet e Bashkisë Shkodër për përballimin e situatave emergjente dhe do të garantonte një organizim më të mirë të burimeve njerëzore në funksion të mbrojtjes së sigurisë së komunitetit.

Aktualisht, Policia Bashkiake Shkodër ka 58 punonjës, të ndarë në dy sektorë:Sektori për Territorin e Qarkullimin dhe Sektori i Kontrollit, Drejtimit, Koordinimit dhe Emergjencave. Në përputhje me ligjin 89/2022, rekrutimi i efektivëve do të kryhet përmes testimeve në disa faza, përfshirë edhe testin fizik sipas kritereve të Akademisë së Sigurisë.
Në përfundim, duke pasur parasysh shtrirjen e gjerë territoriale të Bashkisë Shkodër, numrin dhe shpeshtësinë e situatave emergjente, detyrimet ligjore të Policisë Bashkiake në fushën e emergjencave civile, si dhe gamën e gjerë të kompetencave dhe detyrave që kjo strukturë ushtron në territor dhe në mbështetje të strukturave të tjera të Bashkisë, shtimi i numrit të punonjësve paraqitet si një masë e domosdoshme për forcimin e kapaciteteve njerëzore dhe operacionale, garantimin e mbulimit efektiv të territorit dhe rritjen e cilësisë dhe efektivitetit të shërbimit, **propozojmë:**

Rritjen me **10 (dhjetë)** punonjës të numrit të strukturës aktuale.

- ***Kërkesa për rritjen e numrit të punonjësve tek Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike, institucion në varësi të Bashkisë Shkodër*** *vjen për arsye si vijon:*

Në kuadër të garantimit të kushteve të përshtatshme higjieno-sanitare, të mirëmbajtjes së ambjenteve dhe të sigurimit të një shërbimi sa më cilësor për fëmijët që frekuentojnë kopshtet dhe çerdhet, paraqesim gjithashtu nevojën për shtesë të personelit sanitar në strukturat e arsimit parashkollor dhe shërbimit të përkujdesjes për fëmijët.

Aktualisht, numri i personelit sanitar në disa prej kopshteve dhe çerdheve është i pamjaftueshëm në raport me numrin e fëmijëve, sipërfaqen e ambienteve që duhet të mirëmbahen dhe ngarkesën ditore të punës. Kjo situatë vështirëson realizimin në mënyrë të plotë dhe të vazhdueshme të proceseve të pastrimit, dezinfektimit dhe mirëmbajtjes së ambienteve.

Duke pasur parasysh moshën e fëmijëve që frekuentojnë këto institucione, ruajtja e standardeve të larta të higjienës është një domosdoshmëri. Ambientet e lojës, klasat, korridoret, nyjet sanitare, hapësirat e përbashkëta dhe ambientet e tjera kërkojnë pastrim dhe dezinfektim të vazhdueshëm gjatë gjithë orarit të funksionimit.

Rritja e numrit të fëmijëve dhe ngarkesa e shtuar në institucionet tona kanë sjellë një rritje të konsiderueshme të volumit të punës për personelin sanitar ekzistues. Për këtë arsye, është e nevojshme që numri i punonjësve të përshtatet me nevojat reale të çdo kopshti dhe çerdheje.

Shtesa e personelit sanitar do të mundësojë:

- garantimin e një niveli më të lartë të higjienës dhe pastërtisë në ambiente;
- kryerjen në kohë dhe me cilësi të proceseve të pastrimit dhe dezinfektimit;
- mirëmbajtjen e vazhdueshme të nyjeve sanitare dhe ambienteve të përbashkëta;
- krijimin e një mjedisi më të sigurt dhe të shëndetshëm për fëmijët dhe stafin;
- shpërndarjen më të drejtë të ngarkesës së punës ndërmjet personelit sanitar;
- përmbushjen më efektive të kërkesave dhe standardeve higjieno-sanitare.

Në këto kushte, kërkojmë miratimin e shtesës së **3 punonjës, sanitare**, sipas nevojave të evidentuara për çdo kopsht dhe çerdhe, me qëllim garantimin e kushteve të përshtatshme të higjienës dhe funksionimit normal të institucioneve. Kjo shtesë personeli vlerësohet si e domosdoshme për përballimin e ngarkesës aktuale të punës dhe për garantimin e një shërbimi cilësor, në funksion të mirëqenies, shëndetit dhe sigurisë së fëmijëve.

Gjithsej numri i punonjësve të Bashkisë Shkodër do të jetë sipas tabelës në vijim:

Institucioni	Numri i punonjësve (Ishte)	Numri i punonjësve (Bëhet)	Numri i punonjësve me kontratë
Bashkia Shkodër	659	693	28
Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpetimit	55	55	
Ndërmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike	146	146	10
Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike	248	251	
NUMRI I PUNONJËSVE	**1,108**	**1,145**	**38**

Sa më sipër, i propozojmë Këshillit Bashkiak të miratojë projekt vendimin e paraqitur;

Për një ndryshim në VKB nr.84, datë 18.12.2025 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2026 – 2028 të Bashkisë Shkodër", të ndryshuar";

Duke ju falenderuar!

KRYETAR

Benet BECI

